

<p align="center">BYLAWS OF GREENCELLS ALBANIA CONSTRUCTION SH.P.K.</p>	<p align="center">STATUTI I GREENCELLS ALBANIA CONSTRUCTION SH.P.K.</p>
<p>Based on provisions of the law no. 9901, date 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" as amended, the founding quota holder of the company signs the bylaws of the limited liability company, which defines the purpose, rights and responsibilities of the company as following:</p>	<p>Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ortaku i vetëm themelues i shoqërisë nënshkruan Statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, i cili percakton objektin, te drejtat dhe detyrimet e shoqërisë si më poshte :</p>
<p align="center">CHAPTER I</p> <p align="center">COMPANY'S NAME, REGISTERED OFFICE, DURATION, SCOPE, ACTS</p>	<p align="center">KREU I</p> <p align="center">EMRI, SELIA E REGJISTRUAR, KOHËZGJATJA, OBJEKTI DHE AKTET E SHOQËRISË</p>
<p align="center">ARTICLE 1</p> <p align="center">ESTABLISHMENT, NAME AND REGISTERED OFFICE OF COMPANY</p>	<p align="center">NENI 1</p> <p align="center">KRIJIMI, EMRI DHE SELIA E REGJISTRUAR E SHOQËRISË</p>
<p>1.1 The limited liability company is established by the Act of Incorporation of 05.07.2023 signed by founding sole quota holder of the company.</p>	<p>1.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është krijuar me aktin e themelimit datë 05.07.2023 të nënshkruar nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë.</p>
<p>1.2 The company shall be named "Greencells Albania Construction" Sh.p.k. The name of the company may be written with small or capital letters.</p>	<p>1.2 Shoqëria quhet "Greencells Albania Construction" Sh.p.k. Emri i Shoqërisë mund të shkruhet me gërma të vogla ose të mëdha.</p>
<p>1.3 Registered office of the company is at Blvd" Deshmoret e Kombit, Twin Towers, Bldg.6, Entrance 11, Ap.21, Administrative Unit No.5, 10/19, Tirana,</p>	<p>1.3 Selia e regjistruar e shoqërisë ndodhet në "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Nd.6, H.11, Ap 21, Njesia Administrative Nr.5, 10/19 Tiranë</p>
<p>1.4 "Greencells Albania Construction" company may establish its branches or affiliates.</p>	<p>1.4 Shoqëria "Greencells Albania Construction" shpk mund të krijojë degë dhe filiale të saj.</p>
<p align="center">ARTICLE 2</p> <p align="center">JURIDICAL REGIME OF COMPANY</p>	<p align="center">NENI 2</p> <p align="center">REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË</p>
<p>2.1 The Company is guided by the market economy principles and its goal is to make profit. It shall respect the reciprocity principle.</p>	<p>2.1 Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.</p>

2.2 "Greencells Albania Construction" is a limited liability company (Sh.p.k.). Its activity is subject of provisions of the Act of Incorporation, Bylaws and other provisions of the effective commercial and civil legislation in Albania.	2.2 "Greencells Albania Construction" është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi në Shqipëri.
2.3 The Company may, upon the decision of the General Assembly of Quota holder(s), change the form of juridical regime in compliance with the effective legal provisions and the provisions of its Act of Incorporation and Bylaws.	2.3 Shoqëria, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, mund të ndryshojë formën e regjimit juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj.
2.4 The Company shall enjoy legal personality starting from the date of its registration in the Commercial Register.	2.4 Shoqëria gëzon personalitet juridik duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.
ARTICLE 3 SCOPE OF COMPANY	NENI 3 OBJEKTI I SHOQËRISË
3.1 The Company shall have as a scope carrying out different construction works, especially regarding the agrivoltaic and other renewable projects.	3.1 Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë kryerjen e punimeve të ndryshme ndërtimi veçanërisht lidhur me projektet agrivoltaikë dhe projekte të tjera të energjive të rinovueshme.
3.2 The Company is entitled to enter into any commercial, technical, financial, intangible or tangible transaction that it deems suitable or necessary for the ultimate purposes of achieving the aforementioned scope of its business activity.	3.2 Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, teknik, financiar, mobiluar dhe imobiliar, që konsiderohet i nevojshëm për përmbushjen e objektit të saj të veprimtarisë tregtare të përmendur më sipër.
3.3 The Company may participate in consortiums or temporary unification of companies, domestic or foreign, which have a similar purpose with that of the said company. With the decision of the General Assembly of Quota holder(s) the company may establish new lawful activities inside or outside the country.	3.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në konsorciume ose bashkimi të përkoshme shoqërisht me shoqëri vendase ose të huaja të cilat kanë objekt të veprimtarisë së tyre të ngjashëm me objektin e kësaj shoqërie. Ajo mund të hapë veprimtari të reja të ligjshme si brenda dhe jashtë vendit me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
3.4 For carrying out its activities the company may use its indoor personnel or specialized external personnel.	3.4 Për kryerjen e veprimtarive të saj, shoqëria mund të përdorë personel të brendshëm ose personel të specializuar të jashtëm.
ARTICLE 4 DURATION	NENI 4 KOHËZGJATJA

4.1 The duration of the company is indefinite. The commercial activity of the company starts upon its registration in the Commercial Register.	4.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pacaktuar. Veprimtaria tregtare e shoqërisë fillon pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.
ARTICLE 5 ACTS AND SEAL OF COMPANY	NENI 5 AKTET DHE VULA E SHOQËRISË
5.1 All acts and documents issued by the Company and directed to third parties, such as letters, invoices, notices, announcements etc. must contain the name of the company and the words "limited liability company" or the initials "Sh.p.k", the unique number of identification (NUIS), the registered office, the telephone number and its electronic address.	5.1 Të gjitha aktet dhe dokumentet e lëshuara nga Shoqëria dhe drejtuar palëve të treta, si shkresa, fatura, njoftime, lajmërime etj., duhet të përmbajnë emrin e shoqërisë dhe fjalët "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K", numrin unik të identifikimit (NUIS), selinë e regjistruar, numrin e telefonit dhe adresën elektronike të tij.
5.2 Company shall have its seal with the name "Greencells Albania Construction" and letters Sh.p.k that define the type of the company.	5.2 Shoqëria do të ketë vulën e saj me emrin "Greencells Albania Construction" dhe gërmat Sh.p.k që përcaktojnë tipin e shoqërisë.
CHAPTER II SHARE CAPITAL, QUOTA CERTIFICATE, CAPITAL INCREASE AND DECREASE	KREU II KAPITALI, CERTIFIKATA E KUOTËS ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT
ARTICLE 6 COMPANY'S CAPITAL	NENI 6 KAPITALI I SHOQËRISË
6.1 The Company's share capital is 100 ALL. The capital consisting of 1 (one) quota, representing 100% of the registered quota capital, held by the sole Quota holder, Greencells GmbH.	6.1 Kapitali themelues i Shoqërisë është 100 Lekë. Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar që zotërohet nga Ortaku i vetëm, Greencells GmbH.
6.2 The capital of the Company may change according to a decision that the General Assembly of the Quotaholders may take, but it can never be reduced lower than share capital establishing the Company.	6.2 Kapitali i shoqërisë mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.
ARTICLE 7 QUOTA CERTIFICATE	NENI 7 CERTIFIKATA E KUOTËS

7.1 A quota holder is entitled to one certificate for the respective quota held by the same. Such certificate shall not be considered security and cannot be sold or trade/ in stock exchange markets.	7.1 Mbjtësi i kuotës ka të drejtën e një certifikate për kuotën përkatëse që ai zotëron. Kjo certifikatë nuk duhet të konsiderohet si letër me vlerë dhe nuk mund të shitet apo të tregtohet në bursa.
ARTICLE 8	NENI 8
8.1 Quota holders are liable for the losses of the company up to the amount of invested capital.	8.1 Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet deri në kufirin e kapitalit të investuar.
8.2 Assets created by the company during its activity shall be property of the associates according to the percentage of the share capital they own.	8.2 Pasuritë e krijuara nga shoqëria gjatë veprimtarisë të saj janë në pronësi të ortakëve, në raport me përqindjet e kapitalit themeltar që ata zotërojnë.
8.3 Company's assets may be sold, leased, or pledged with approval of all quota holders.	8.3 Pasuritë e shoqërisë mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë me miratimin e të gjithë ortakëve.
ARTICLE 9 QUOTAS' TRANSFER	NENI 9 TRANSFERIMI I KUOTAVE
9.1 Quotas of capital may be transferred to the successors or heirs of the founding quota holder of the company in form of inheritance according to the legislation in force.	9.1 Kuotat e kapitalit mund t'i transferohen pasardhësve të ortakëve themelues të shoqërisë në formë trashëgimie sipas legjisllacionit në fuqi.
9.2 For any transferring of quotas to third parties it is necessary the preliminary approval of the General Assembly. In any case, the quota holders of the company have the preemptive right of purchasing quotas.	9.2 Për çdo transferim të kuotave të palët e treta është e nevojshme miratimi paraprak nga Asambleja e Përgjithshme të Ortakëve. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes së kuotave.
9.3 The quota holders may transfer his/her quotas to a third person outside the company only when none of other quota holders exercises the preemptive right of purchasing them according to this Article.	9.3 Ortakët mund t'i transferojnë kuotat e tyre një personi të tretë jashtë shoqërisë vetëm kur asnjë nga ortakët e tjerë nuk ushtron të drejtën e parablerjes sipas këtij neni.
ARTICLE 10 INCREASE AND DECREASE OF SHARE CAPITAL	NENI 10 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT
10.1 Share capital may be increased or decreased upon the decision of the General Assembly with a majority of 3/4 of votes.	10.1 Kapitali themelor mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me një shumicë vendimmarrëse prej tre të katërtat të votave.
10.2 The increase of share capital may be decided when it is required by the interest	10.2 Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të ortakëve.

of the company deciding the supplementary quotas of the associates.	
10.3The General Assembly may decide to decrease the share capital of the company. The decrease of share capital should neither damage creditors nor create uncertainties for those who have provided loans before the publication of the decrease of share capital.	10.3Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit.
ARTICLE 11 RIGHTS AND OBLIGATIONS OF QUOTAHOLDERS	NENI 11 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE
11.1Quota holders shall provide their contribution in money or in kind for the company according to the manners and deadlines established in this Bylaws. They may be accountable towards the company either individually or collectively for any damage incurred from their default to accomplish the obligations or from their delayed accomplishment beyond the related deadlines.	11.1Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.
11.2Persons responsible for the management of the company shall keep all quota holders informed about the activity of the commercial company, and upon their request, may provide annual accounts including consolidated accounts, reports on the state and progress of the company, reports of the statutory bodies or authorized accounting experts.	11.2Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar.
11.3Quota holders may withdraw from the company and they may sell their quotas of share capital in compliance with terms provided for in this Bylaws and the effective legislation.	11.3Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë ngashoqëria dhe mund të shesin kuotat e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi.
11.4Withdrawal from the company shall not free the quota holders from their obligations till the moment of withdrawal and shall not prevent them to receive any profit that the company has made till that moment.	11.4Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet që kanë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk i cënon ata në marrjen e fitimit që shoqëria ka siguruar deri në këtë moment.
11.5Quota holders while exercising their rights shall act taking into account the company's and other associates interests.	11.5Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata

<p>They comply with the obligations deriving from the Act of Incorporation and the Bylaws. They make all efforts for carrying out the activity of the company according to its purpose.</p>	<p>gëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për kryerjen e veprimtarisë së shoqërisë sipas objektit të saj.</p>
<p style="text-align: center;">ARTICLE 12 ABUSES OF QUOTAHOLDERS TOWARDS COMPANY</p>	<p style="text-align: center;">ENI 12 ABUZIMI I ORTAKËVE NDAJ SHOQËRISË</p>
<p>12.1 Quota holders of the company conducting or not one of the following actions shall be accountable individually or collectively for the obligations of the company with all their personal property if:</p> <ul style="list-style-type: none"> • abuse with the form of the company to reach illegal objectives; • treat the company's assets as it was their individual property; • at the moment when they are aware or should have been aware for an insolvency of the company, they do not take the necessary measures to make sure the company, depending on the type of performed activity, has sufficient capital to comply with its obligations to third parties. 	<p>12.1 Ortakët e shoqërisë, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> • abuzojnë me formën e shoqërisë për arritjen e qëllimeve të paligjshme; • trajtojnë pasuritë e shoqërisë si të ishin pasuritë e tyre; • në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.
<p style="text-align: center;">ARTICLE 13 WITHDRAWAL OF A QUOTAHOLDER FROM THE COMPANY AND QUOTA LIQUIDATION</p>	<p style="text-align: center;">ENI 13 LARGIMI I ORTAKUT NGA SHOQËRIA DHE LIKUIDIMI I KUOTËS</p>
<p>13.1 Any quota holder may leave the company in case other quota holders or the company have acted in his/her detriment, or if he/she is prevented to exercise his/her rights, or if the company has charged him/her with unreasonable obligations or other causes that make unable the continuation of the partnership. The quota holder asking to leave should notify the company in writing describing the reasons of leave. The Sole Director should call the meeting of the General Assembly right</p>	<p>13.1 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit. Administratori duhet të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të ortakëve menjëherë pasi të kenë marrë dijeni</p>

<p>after the quota holders have received the notification for the leave in order to decide whether the quota of the leaving quota holder shall be liquidated as a consequence of reasonable causes.</p>	<p>për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.</p>
<p>13.2A quotaholder has the right to file with the court a lawsuit against the company for the liquidation of his/her quotas as a consequence of reasonable cause, in case that after the notification of leaving the General Assembly shall not convene or it does not consider as reasonable the causes of leaving and the liquidation of quotas.</p>	<p>13.2Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.</p>
<p>13.3The quotaholder asking to leave the company is obliged to indemnify the company for the incurred damages in case the leaving is made without a reasonable cause.</p>	<p>13.3Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.</p>
<p>CHAPTER III</p> <p>CORPORATE GOVERNANCE</p>	<p>KREU III</p> <p>QEVERISJA E SHOQËRISË</p>
<p>ARTICLE 14</p> <p>STATUTORY BODIES</p>	<p>NENI 14</p> <p>ORGANET DREJTUESE</p>
<p>14.1The statutory bodies of the company are:</p> <ul style="list-style-type: none"> - General Assembly of the Quotaholders; - Sole Director of the Company. 	<p>14.1Organet drejtuese të shoqërisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Administratori i vetëm i shoqërisë
<p>14.2 Rights and competencies of the statutory bodies are defined in this bylaw.</p>	<p>14.2 Të drejtat dhe kompetencat e organeve drejtuese janë përcaktuar në këtë statut.</p>
<p>ARTICLE 15</p> <p>GENERAL MEETING</p>	<p>NENI 15</p> <p>ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME</p>
<p>15.1The superior statutory body of the company is the General Assembly of Quota holders. The General Assembly as a rule is convened in the seat of the company. The General Assembly may convene in another place other than the seat of the company when it is approved by not less than 2/3 of votes of quota holders in proportion to quota participation in the share capital of the company.</p>	<p>15.1Organi drejtues më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e ortakëve. Asambleja e Përgjithshme si rregull mblidhet në selinë e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të mblidhet në një vend të ndryshëm nga ai i selisë së shoqërisë kur për të kanë dhënë miratimin jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të saj në proporcion me pjesëmarrjen e kuotave në kapitalin e shoqërisë.</p>
<p>15.2The General Assembly is convened at least every 6 months.</p>	<p>15.2Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mblidhet të paktën një herë në 6 muaj.</p>

<p>15.3 The Assembly may be called by one of Quota holders or the Sole Director of the company. The Assembly will be led by one of the Quota holders. He/she will be assisted by a Secretary who will be appointed by the Quota holders upon proposal of the Sole Director.</p>	<p>15.3 Asambleja mund të thirret nga një prej ortakëve ose nga Administratori i Shoqërisë. Asambleja drejtohet nga një prej ortakëve. Ai asistohet nga një sekretar i cili emërohet nga Ortakët me propozim të Administratorit.</p>
<p>15.4 The Assembly is called at least once a year within 6 months from the end of the financial exercise to approve the annual accounts.</p>	<p>15.4 Asambleja thirret të paktën një herë në vit, për të miratuar llogaritë vjetore, brenda 6 muajve nga mbarimi i vitit ushtrimor.</p>
<p>15.5 The decisions of the General Assembly shall be made with the majority required by the effective law.</p>	<p>15.5 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve do të merren me shumicën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi.</p>
<p>15.6 The minutes of the meeting of the Assembly shall be signed by the Secretary and the Chair of the Assembly, and by the public notary if the latter is requested to attend the meeting.</p>	<p>15.6 Proces - verbali i mbledhjes së Asamblesë do të firmoset nga sekretari dhe kryetari i Asamblesë dhe nga noteri nëse do të jete kërkuar të jete prezent gjatë mbledhjes.</p>
<p style="text-align: center;">ARTICLE 16 RIGHTS AND OBLIGATIONS OF GENERAL ASSEMBLY</p>	<p style="text-align: center;">NENI 16 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME</p>
<p>16.1 The General Assembly decides on:</p> <ul style="list-style-type: none"> • definition of commercial policies of the company; • changes of the bylaw; • appointment and removal of the Sole Director; • appointment and removal of liquidators and authorized accounting experts; • determination of compensations for the Sole Director, liquidators and authorized accounting experts; • supervision of implementation of commercial policies by the Sole Director, including compilation of annual financial statements and reports on performance of activity; • approval of annual financial statements and reports on performance of activity; • capital increase and decrease; 	<p>16.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; • ndryshimet e statutit; • emërimin e shkarkimin e administratorit; • emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; • përcaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar; • mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë; • miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë; • zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; • pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

<ul style="list-style-type: none"> • division of quotas and their cancellation; • representation of the company in the court and other proceedings against the Sole Director; • restructuring and dissolution of the company; • approval of rules of procedures for the Assembly meetings; • other issues as may be provided for by the law. 	<ul style="list-style-type: none"> • përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; • riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; • miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë; • çështje të tjera të parashikuara nga ligji.
ARTICLE 17 DIRECTOR OF COMPANY	NENI 17 ADMINISTRATORI I SHOQËRISË
17.1 The company shall be administered by the Sole Director of the company.	17.1 Shoqëria administrohet nga Administratori i shoqërisë.
17.2 The first Sole Director of the company is appointed Mr. Andreas Hoffmann.	17.2 Administratori i parë i shoqërisë është emëruar Z. Andreas Hoffmann.
17.3 The Director of the company is a physical person otherwise its appointment shall not be valid. He/she may be selected outside the employees of the company. The Director of the company can be removed from the General Assembly at any time with the simple majority of votes.	17.3 Administratori i shoqërisë është person fizik, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai mund të zgjidhet edhe jashtë të punësuarve në shoqëri. Administratori i shoqërisë mund të shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në çdo kohë me shumicën e thjeshtë të votave.
17.4 The Director of the company shall be appointed for a period of 5 (five) years.	17.4 Administratori i shoqërisë emërohet për një periudhë kohe prej 5 (pesë) vjetësh.
17.5 The Director of the company may be re-appointed.	17.5 Administratori i shoqërisë mund të riemërohet.
17.6 In case when the Director of the company resigns or is removed, he/she will continue to exercise his/her duty until the appointment of the new Director.	17.6 Në rast kur Administratori i shoqërisë jep dorëheqje ose shkarkohet, ai do t'i ushtroje funksionet e tij deri në emërimin e një administratori tjetër.
17.7 The salary of the Sole Director is set by the General Assembly in the act of his/her appointment.	17.7 Paga e Administratorit caktohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në aktin e emërimit të tij.
ARTICLE 18 RIGHTS AND DUTIES OF DIRECTOR	NENI 18 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORIT
18.1 Sole Director has full competences to act on behalf of the company complying with the provisions of this bylaw and the legislation in force.	18.1 Administratori ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë sipas dispozitave të statutit dhe legjislacionit në fuqi.

18.2 Sole Director shall be legally accountable for the performance of the company and implementation of this bylaw and the legislation in force.	18.2 Administratori mban përgjegjësi ligjore për mbarëvajtjen e shoqërisë dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe të Statutit të shoqërisë.
18.3 Sole Director has the right that within his/her competences, to delegate to one or more company employees the right to perform specific acts or category of acts.	18.3 Administratori ka të drejtë që brenda kompetencave të tij t'u japë një ose disa punonjësve të shoqërisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejtën e nëndelegimit.
18.4 In the relations with third parties, the company takes the responsibility for the obligations deriving from acts signed by the Sole Director even in cases these acts go beyond the purpose of the company, except the cases when the company proves that the third parties knew that such an act fell beyond the purpose of the company and the Sole Director was not acting in bonafide, or when the third parties could not ignore this act taking into account the fact that the enactment of the bylaw is not a sufficient prove.	18.4 Në marrëdhëniet me të tretët shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e nënshkruara nga administratori edhe kur këto akte e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i administratorit kapërcen objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe se ai nuk vepronte në mirëbesim (<i>bonafide</i>), ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.
18.5 Sole Director should, within three months from the date of closing of the financial exercise, present to the General Assembly the annual accounts for purpose of verification and control.	18.5 Brenda tre muajve nga data e mbylljes së vitit ushtrimor financiar administratori duhet t'i paraqesë Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.
18.6 Acts under which the company takes obligations towards third parties should be signed by the Sole Director of the company or a duly authorized person by him/her for these acts.	18.6 Aktet me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nënshkruhen nga administratori i shoqërisë ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.
18.7 Sole Director of the company shall prepare the organization chart of the company, which shall be approved by the General Assembly.	18.7 Administratori i shoqërisë përgatit strukturën organizative të Shoqërisë, e cila miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
ARTICLE 19	ENI 19
AGREEMENTS BETWEEN COMPANY AND DIRECTOR	MARRËVESHJET NDËRMJET SHOQËRISË DHE ADMINISTRATORIT
19.1 Any agreement between the company and the Sole Director of the Company, either directly or indirectly, shall be subject of preliminary authorization of the General Assembly.	19.1 Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe administratorit të shoqërisë, qoftë e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

19.2 This article shall not be applicable for the agreements related to deriving activity of the company under normal conditions.	19.2 Ky nen nuk është i zbatueshëm për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë rrjedhëse të shoqërisë që kryhet në kushte normale.
19.3 Sole Director of the company should notify the General Assembly for any such agreement that is subject of the requirements of this article. If the Sole Director of the company is one of the quota holders, he/she shall not participate in the voting of authorization.	19.3 Administratori i shoqërisë duhet të njoftojë Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve për një marrëveshje për të cilën zbatohen kërkesat e këtij neni të statutit. Nëse administratori i shoqërisë është një nga ortakët ai nuk merr pjesë në votimin për dhënien e autorizimit.
CHAPTER IV	KREU IV
PROVISIONS ON FINANCIAL ASPECTS OF COMPANY	DISPOZITA LIDHUR ME ASPEKTET FINANCIARE TË SHOQËRISË
ARTICLE 20 FINANCIAL AUDIT	NENI 20 AUDITI FINANCIAR
20.1 Company's financial audit shall be performed by Certified Public Accountants, pursuant to Albanian law provisions in full force and effect. The General Meeting may appoint one or more Certified Public Accountants.	20.1 Auditimi Financiar i Shoqërisë do të kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme mund të caktojë një ose më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar.
ARTICLE 21 FINANCIAL YEAR	NENI 21 VITI FINANCIAR
21.1 Company's financial year commences on January 1 st and ends on December 31 st of each year.	21.1 Viti financiar i shoqërisë fillon në 1 janar përfundon në 31 dhjetor të çdo viti.
ARTICLE 22 INVENTORY AND ANNUAL FINANCIAL STATEMENTS	NENI 22 INVENTARI DHE PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
22.1 The company shall keep regular accounting records of assets and activities in compliance with the requirements of the effective legislation.	22.1 Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe veprimtarisë të saj, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
22.2 At the end of the financial exercise, the Sole Director of the company shall compile the inventory of the assets and the annual accounts as of this date for the financial exercise.	22.2 Në mbylljen e ushtrimit financiar, administratori i shoqërisë harton inventarin e pasurive deri në atë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar.

22.3 The Sole Director shall also prepare the management report on the state of the company during the financial exercise.	22.3 Administratori i shoqërisë përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar.
22.4 The annual balance sheet, financial statements, inventory and reports of the Sole Director as well as of the Certified Public Accountants are submitted to the General Meeting for acceptance and approval.	22.4 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari dhe raportet e Administratorit si dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, paraqiten në Asamblenë e Përgjithshme për pranim dhe miratim.
ARTICLE 23 EXERCISE RESULT AND PROFIT DEFINITION	NENI 23 REZULTATI I USHTRIMIT DHE PERCAKTIMI I FITIMIT
23.1 The result of the exercise is determined as the difference of revenues with exercise expenses after the deduction of net loss of previous year.	23.1 Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm.
23.2 The General Assembly may decide to subtract from the profit of exercise, if it is the case, the losses of a previous exercise period to create the necessary reserve of the company.	23.2 Nga fitimet e ushtrimit të pakësuara, kur është rasti, me humbjet e një periudhë ushtrimore të më mëparshme, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë heqjen e një pjesë të fitimit për të krijuar rezervën e domosdoshme të shoqërisë.
23.3 The use of profit after the deduction of the legal reserve is made according to the decision of the General Assembly.	23.3 Përdorimi i fitimit pas zbritjes së rezervës ligjore, bëhet me urdhër të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
ARTICLE 24 RESERVE FUNDS	NENI 24 FONDET REZERVË
24.1 The company shall establish a reserve fund and other financial funds to meet its economic needs. The Company shall dispose freely its financial means for payment of obligations during its activity.	23.1 Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerien e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.
CHAPTER V REORGANIZATION, LIQUIDATION AND SETTLEMENT OF DISPUTES	KREU V RIORGANIZIMI, LIKUIDIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE
ARTICLE 25 REORGANIZATION AND LIQUIDATION	NENI 25 RIORGANIZIMI DHE LIKUIDIMI

<p>25.1 In case of Company's reorganization or liquidation, the provisions of Law no. 9901 dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" as amended and other effective legislation shall apply. The General Assembly shall resolve on Company's reorganization or liquidation with a majority of three quarters of quota holders' votes attending the meeting. Such meeting is duly convened only if participate quota holders representing more than half of the total voting rights.</p>	<p>25.1 Në rastin e riorganizimit ose likuidimit të Shoqërisë, do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë për riorganizimin apo likuidimin e Shoqërisë me një shumicë prej 3/4 e votave të ortakeve të pranishëm në mbledhje. Asambleja konsiderohet e mbledhur rregullisht, nëse janë të pranishëm ortaket që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e të drejtës së votave në total.</p>
<p style="text-align: center;">ARTICLE 26 SETTLEMENT OF DISPUTES</p>	<p style="text-align: center;">NENI 26 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE</p>
<p>26.1 Any disputes arising out and between the Company and its quota holder(s), or between quota holders and their heir or amongst them and/or the Company, shall be amicably settled between the interested parties. Should such settlement of the dispute fail, Tirana District Court shall be the competent authority for such settlement.</p>	<p>26.1 Çdo mosmarrëveshje midis Shoqërisë dhe ortakeve të saj, ose mes ortakeve dhe trashëgimtarit, ose ndërmjet tyre dhe/ose Shoqërisë, do të zgjidhet miqësisht midis palëve të interesuara. Nëse një zgjidhje e tillë dështon, autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.</p>
<p style="text-align: center;">NENI 27 FINAL PROVISIONS</p>	<p style="text-align: center;">NENI 27 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE</p>
<p>23.1 Herein By-Laws was drafted in 3 (three) copies in Albanian and English, and was accepted and signed by the Sole Quota holder as of 08.05.2023.</p>	<p>23.1 Akti nënligjor u hartua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe angleze, u pranua dhe nënshkrua nga Ortaku i vetëm sot në date 08.05.2022.</p>
<p style="text-align: center;">Sole Quota holder of Greencells Albania Construction Sh.p.k Represented by:</p>	<p style="text-align: center;">Ortaku i vetëm i Greencells Albania Construction Sh.p.k Përfaqësuar nga:</p>

Andreas Hoffmann



Full name and Signature